



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. Nr. 01/1555 Datë: 08.09.2022

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan shpall:

KONKURS PLOTËSUES

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore - baçelor për vitin akademik 2022/2023

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 98 dhe 101 të Statutit, në mbledhjen e XXXIV të mbajtur më 14.06.2022, ka miratuar propozimet e njësisve akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2022/23. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejme MASHTI) sipas Referencës 01B - Nr. prot. 1698 dt. 08.07.2022.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve, në afatin plotësues të konkursit për vitin akademik 2022/2023, do të regjistrojë 222 studentë të rregullt në studime themelore baçelor.
2. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht 60 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja **2%**. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri 8 studentë baçelor. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen edhe **2%** e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, përkatësisht 11 studentë të rregullt.



5. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, mund të pranohen **1%** të kandidatëve nga Mali i Zi, përkatësisht **5** studentë të rregullt.
6. Kandidatët nga Shqipëria, mbështetur në marrëveshjen e datës 20.06.2022 e lidhur ndërmjet dy ministrive respektive, mund të regjistrohen edhe në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve me kushte të barabarta me ata kosovarë.
7. Universiteti do t'i ketë në konsideratë në mënyrë të veçantë edhe kandidatët me nevoja të veçanta të cilët e kalojnë pragun e provimit pranues.
8. Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
9. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet të verifikohet njohja e institucionit shkollor në bazë të listës së MASHTI-t, e cila u dorëzohet të gjitha njësive akademike.
10. Kandidatët të cilët kanë diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
11. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
12. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në **gjuhën e komunitetit** në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
13. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
14. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit "Kadri Zeka" nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
15. Kandidatët për pranim si student në Universitetin "Kadri Zeka" në vitin akademik 2022/23 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:
 - a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

10/11/2022

- b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:
Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë;
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
 3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
 4. Kandidatët nga Lugina e Preshevës, Shqipëria, Maqedoni, Mali i Zi dhe komunitetet, mund të rangohen në listën e të pranuarve nëse kanë arritur së paku **30%** të pikëve nga provimi pranues.
 5. Për kandidatët të cilët konkurrojnë nga Republika e Shqipërisë në kuadër të listës me kandidatët kosovarë rangohen në listën e të pranuarve ata të cilët kanë arritur së paku 40% të pikëve nga provimi pranues.
 6. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online smu.uni-gjilan.net hapet prej datës **09.09.2022** deri më datë **19.09.2022** në ora **16.00**.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë 09.09.2022, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **10:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **09.09.2022** deri më datë **19.09.2022 duke përfshirë edhe ditën e shtunë**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personeli i administratës së fakultetit përkatës.
4. Më **20.09.2022** do të publikohet në ueb-faqen e universitetit lista e kandidatëve dhe sallave ku do të mbahet provimi pranues.
5. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve dhe të njëjtat t'i noterizojnë (vula noterit duhet të jetë origjinale), sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo ç 'regjistrim nga fakulteti.

6. Provimi pranues mbahet më 21.09.2022 sipas orarit si në vijim:

Grupi I.

1. Fakulteti i Edukimit – baçelor më datë **21.09.2022** në ora **9:00**

Grupi II.

1. Fakulteti i Juridik - baçelor më datë **21.09.2022** në ora **9:00**

Grupi III.

1. Fakulteti i Ekonomik - baçelor më datë **21.09.2022** në ora **12.00**

Grupi IV.

1. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike – baçelor më datë **21.09.2022** në ora **12:00**

- **Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

7. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim online dhe fizik është si në vijim:

- a) *Ekstrakti i lindjes (origjinal) jo më i vjetër se 6 muaj,*
- b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë),*
- c) *Diploma e kryerjes së shkollës së mesme (origjinal, të noterizuar ose dublikatë),*
- d) *Dëftesa e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikatë),*
- e) *Kopjen e letërnjoftimit,*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: smu.uni-gjilan.net***
- g) **Vegza (linku) për konkurrim online përmes internetit është: smu.uni-gjilan.net, ndërsa pagesa bëhet në cilëndo bankë (këtë duhet verifikuar sipas UA te MASHTIT për pagesat).**
- h) *Dëshmia mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit - Lista e institucioneve parauniversitare të licencuara në vend, sigurohet në MASHTI (nëse kandidatët nuk mund ta sigurojnë këtë dëshmi gjatë periudhës së aplikimit online, atëherë dëshmia mund të dorëzohet me rastin e aplikimit fizik).*

8. Me rastin e aplikimit të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e kërkuara si në pikën 7 të këtij kapitulli, t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosie (fashikull) të bardhë, e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.

9. Dokumentet nën pikën b) c) dhe d) mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohen me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. *P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati, pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.*

11/11/2022

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. Shpallja e rezultateve preliminare e provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e universitetit sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë: **më së voni deri më datë 23.09.2022, në ora 16:00;**
2. *Me rastin e shpalljes së rezultatit preliminar nuk nënkuptohet se kandidati është pranuar, sepse pas ankesës dikush nga kandidatët mund të radhitet me lartë me pikë se kandidati i cili ishte radhitur sipas rezultatit preliminar.*

V. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të papranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** respektivisht për grupet si në vijim: **Ankesat bëhen më së voni deri më datë 26.09.2022, në ora 16:00;** **Ankesa duhet të bëhet përmes sistemit në mënyrë online, vegza (Linku): smu.uni-gjilan.net dhe e njëjta duhet të dorëzohet fizikisht pranë zyrave të shërbimit të studentëve të njëjësive akademike përkatëse, me dt. 26.09.2022 deri në ora 16:00 .**
2. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshënuar ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet më **27.09.2022** në orën 10.00 nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës .
3. Vetëm ankesat e bazuara mundë të procedohen në Komisionin Qendror të ankesave i cili komision merr vendim përfundimtar më datë **28.09.2022** dhe më pastaj publikohen rezultatet përfundimtare.
4. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **29 dhe 30.09.2022 nga ora 9.00 deri në 16.00.**
5. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-gjilan.net

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e universitetit, pas shqyrtimit të ankesave sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë: **më së voni deri më datë 28.09.2022, deri në orën 16:00;**

VI. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. **Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në bazë të orarit si në vijim:**
 - Fakulteti i Edukimit më 29.09.2022
 - Fakulteti Juridik më 29.09.2022
 - Fakulteti Ekonomik



- i. Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar më 30.09.2022
- ii. Menaxhment dhe Ndërmarrësi më 30.09.2022
- Fakulteti i Shkencave Kompjuterike më 03.10.2022

2. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
3. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.

STUDIMET BAÇELOR

Tabela me numrat e paraparë për studentë të rinj për vitin akademik 2022-2023 sipas njësive akademike dhe programeve

Fakulteti	Programi	Nga Kosova	Lugina e Preshevës 2%	Komunitetet Jo-shumicë 12%	Shqipëria & Maqedonia 2%	Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukim	Fillor	0	0	5	1	0	6
	Parashkollor	0	1	4	1	0	6
Ekonomik	Financë dhe Kontabilitet i Aplikuar	57	2	12	2	1	74
	Menaxhment dhe Ndërmarrësi	26	1	9	2	1	39
Juridik		20	2	12	2	1	37
Shkenca Kompjuterike		35	2	18	3	2	60
TOTAL		138	8	60	11	5	222

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

I. FAKULTETI I EDUKIMIT

- **Programi Fillor:** Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare
- **Programi Parashkollor:** Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Edukatë qytetare

II. FAKULTETI EKONOMIK

- **Të gjitha drejtimit:** Hyrje në ekonomi dhe Matematikë

III. FAKULTETI JURIDIK

- **Juridik i Përgjithshëm:** Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Edukatë qytetare.

IV. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

- **Shkenca Kompjuterike:** Informatikë dhe Matematikë.

